



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802414/19

Tiranë ___/___/2019

Lënda : *"Ushtrimin e së drejtës, përgjegjësisë, për marrjen e masave të vlerësuara nga ju të përshtatshme për të garantuar zbatimin e ligjit dhe pronën e dhënë me qira prej ish-Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës".*

Nxjerrjen e aktit për normimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të funksioneve në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit".

Drejtuar : **Ministrit të Drejtësisë**
Zj. Etilda Gjonaj

TIRANE

**Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve
Gjyqësor Privat.**

Z. Tedi Malaveci

Adresa: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa 9, Kati 2.

E nderuar zj. Ministre!

Në cilësinë e organit i cili ka për detyrë nisjen e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor privat, (nenit 50 i ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor", i ndryshuar, kur konstatohen shkelje të detyrës apo veprime të parregullta gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana e tij, parashtrijmë para jush çështjen si vijon:

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në proces shqyrtimi çështjen e prezantuar prej shtetasit AA., në të cilën ai ngreh shqetësimin e kryerjes së veprimeve përmbarimore të parregullta prej përmbaruesit gjyqësor privat, z. L.C., në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të përkohshëm (sigurim padie) nr. 14256, datë 09.11.2018, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me objekt:

“Për lirimin e menjëhershëm të truallit objekt gjykimi, pasuri e paluajtshme me nr.3/246, me sipërfaqe 1299, vol 33, fq 177, Zona Kadastrale 8270, e ndodhur në Tiranë, Rruga “Vaso Pasha”,

ndryshuar nga po kjo Gjykatë, me Vendimin nr. 1144, datë 04.12.2018, me përcaktimin:

“Sqarimin dhe interpretimin e Vendimit Gjyqësor nr. 14256, datë 09.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për marrje mase provizore, sigurim padie, duke vendosur lirim të menjëhershëm të truallit, dhe jo për objekte mbi këtë truall, pasi nuk janë konstatuar të tillë”.

Me rastin e pranimit për shqyrtim të këtij rasti, është kërkuar me shkresën nr.K3/A113-2 Prot, datë 07.12.2018, përmbaruesit gjyqësor privat të çështjes, z. L.C., vënia në dispozicion të Avokatit të Popullit, të të gjithë akteve të administruara në dosjen përmbarimore me rastin e pranimit të kërkesës së palës kreditore për vënien në ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, Përmbaruesi Gjyqësor Privat, z. L.C., me shkresën nr.602/01 Prot, datë 14.12.2018, shpreh qëndrim refuzues për dhënien e informacionit të kërkuar, duke u shprehur se :

“... ajo çfarë konstatojmë në shkresën tuaj është e paqartë për arsye se tek “Lënda” kërkohet vetëm informacion e shpjegime, ndërkohë që duke lexuar me kujdes shkresën, konstatohet që nga ana juaj kërkohet i gjithë dokumentacioni që i përket praktikës së rastit

Në të tilla kushte, ju bëjmë me dije, se, referuar ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, përkatësisht në nenin 32, gërma “dh”, urdhërohet që, citoj : “dh” të ruaj sekretin profesional dhe të mos zbulojë të dhëna, që i kanë mësuar gjatë veprimtarisë së tyre profesionale ose nga dokumentete, që i janë vënë në dispozicion nga palët në proces ekzekutimi, përveç kur dhënia e këtij informacioni është detyrim ligjor.

Po kështu në nenin 36 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, urdhërohet se kujt mund t’i jepet informacion dhe llojin e informacionit, përkatësisht citoj ...

Gjithashtu, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, është përcaktuar funksioni i përmbaruesit gjyqësor, ku citoj...

E parë kjo dispozitë në harmoni me nenin 28 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, citoj... ju informojmë se, nuk mund të vemë në dispozicion dokumentacionin i cili përmban të dhëna personale”.

Qëndrimin si më sipër cituar të z. C, nuk e vlerësojmë profesional, dhe për më tepër e konsiderojmë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Shprehja e qëndrimit prej z. C, sikurse cituar në paragrafin e parë, është tregues i moskuptimit nga ana e tij, se çfarë nënkupton termi “Informacion publik”. Sipas

parashikimit të kryer në nenin 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” termi “*Informacion publik*” ka kuptimin :

“E çdo të dhëne të regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.

Referuar kuptimit që i është dhënë termit “*Informacion publik*”, paqartësia e kërkit prej Institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse shprehet z.C, nuk ekziston. Kjo situatë vjen për shkak të moskuptimit prej Përmbauesit Gjyqësor Privat, z.C të termit “*Informacion publik*”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në shkresën nr.K3/A113-2 Prot, datë 07.12.2018, drejtuar Përmbauesit gjyqësor privat, ka bërë me dije shkaku ligjor mbi të cilin mbështetet kërkesa për dhënie informacioni dhe shpjegimesh për çështjen objekt ekzekutimi.

Ky shkak është parashikuar në nenin 63, pika “4”, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, se : “*Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij*“, si dhe parashikuar në nenin 19, pika “b”, të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*“, të ndryshuar, se : “*Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”.

Përpos parashikimeve të sipërcituar, sjellim në vëmendje, se, në nenin 20 të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*“, të ndryshuar, parashikohet e drejta e Avokatit të Popullit për të kërkuar informacione apo dokumente sekret shtetëror, citojmë:

“E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekret shtetëror

Avokati i Popullit ka te drejte te kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, te klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj zj.Ministre, faktin se, Avokati i Popullit është Institucion i parashikuar nga Kushtetuta në nenet 60-63, dhe se dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*“, të ndryshuar, me parashikimet e tyre, prevalojnë ndaj dispozitave të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “*Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat*”, i ndryshuar, për shkak se, ligji organik, “*Për Avokatin e Popullit*”, është miratuar me shumicë të cilësuar, 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, (neni 81/a i Kushtetutës) përkundër shumicës së thjeshtë me të cilin është miratuar ligji nr.10031, datë 11.12.2008 “*Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat*”, i ndryshuar. Në çdo rast funksioni i përmbauesit gjyqësor është një funksion publik.

Në këtë situatë, deklaratimet dhe qëndrimi i shprehur prej përmbauesit gjyqësor privat në shkresën nr. 602/01 Prot, datë 14.12.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, i vlerësojmë në shpërdorim ose interpretim të njëanshëm të fuqisë vetjake e të lirisë së gjykimit ose të veprimit.

Referuar parashikimit të nenit 22/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, se :

“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masve disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”,

si dhe parashikimit të kryer në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”, apo parashikimit të kryer në nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË

“Ushtrimin e së drejtës, përgjegjësisë, për marrjen e masave të vlerësuara nga ju të përshtatshme për të garantuar zbatimin e ligjit dhe pronën e dhënë me qira prej ish-Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës”.

Sipas kompetencës të përcaktuar në ligjin nr.10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, për ju z.Malaveci, në cilësinë e Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësor Privat, rekomandojmë:

“Nxjerrjen e aktit për normimin e veprimeve të përmbartuesit gjyqësor privat, gjatë ushtrimit të funksioneve në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit”.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform parashikimit të kryer në nenin 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të shkresës nr.602/01 Prot, datë 14.12.2018, të përmbartuesit gjyqësor privat të çështjes, z.L.C., drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të Vendimit Gjyqësor të përkohshëm nr. 1144, datë 04.12.2018, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë

KOMISIONERI

Vilma SHURDHA

Konceptoi dhe Daktilografoi: A.Gjoleka

